

VENDIM
Nr.830, datë 3.12.2014

**PËR DHËNIEN, NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, NGA
MINISTRIA E MBROJTJES, MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TË NJË
SIPËRFAQEJE TRUALLI BRENDA TERRITORIT TË PRONËS ME NUMËR RENDOR
240, ME EMËRTIMIN “FLOTILJA DETARE E VERIUT”, ME VENDNDODHJE TE
KEPI I PALIT (BISHTI I PALLËS), KATUND I RI, DURRËS, PËR PROJEKTIN
“ADRIARADNET”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, neneve 901 e vijues, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie, në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, për një periudhë 10-vjeçare, nga Ministria e Mbrojtjes, Ministrisë së Punëve të Brendshme, të një sipërfaqeje trualli prej 25 (njëzet e pesë) m², brenda territorit të pronës me numër rendor 240, me emërtimin “Flotilja Detare e Veriut”, me vendndodhje te Kepi i Palit (Bishti i Pallës), Katund i Ri, Durrës, për instalimin e një radari për monitorimin hidrometeorologjik, për projektin “ADRIARADNET”.

2. Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Punëve të Brendshme të lidhin marrëveshje për dhënie, në përdorim, pa shpërblim, të sipërfaqes së truallit, sipas pikës 1, të këtij vendimi, duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet për secilin institucion. Në marrëveshje të përcaktohet, gjithashtu, edhe sipërfaqja ku do të vendoset radari, në bazë të një genplani/planvendosjeje, që do bëhet pjesë e kësaj marrëveshjeje.

3. Ministrisë së Punëve të Brendshme i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama